



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr. 12, datë 18.01.2024

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 375, DATË 13.07.2023 “PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE PËR NË FORMIMIN FILLESTAR PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQJAR, NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85, pika 1 dhe nenin 86, shkronja “ë”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, të vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar, si dhe vendimin nr. 375, datë 13.07.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, vendimin nr. 738, datë 12.12.2023 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Dritan Hallunaj”, si dhe pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 375, datë 13.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “ Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, nënpika 11, si më poshtë:

Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...}
2. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 375, datë 13.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “ Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, nënpika 29, si më poshtë:

Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...}

3. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 375, datë 13.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “ Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, nënpika 35, si më poshtë:

Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...}

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kandidatëve të përfshirë në pikën 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR